



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/20

Datë: 24.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për fushën e Prokurimit Publik.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

**KONCEPT DOKUMENTI PËR FUSHËN E PROKURIMIT
PUBLIK**

Kapitulli 1: Hyrje

Në kuadër të Planit të Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave dhe Raportit të Progresit për vitin 2014, është përcaktuar si sfidë zbatimi i Ligjit të Prokurimit Publik, prandaj në rrjedhë të saj si dhe duke marrë parasysh vështirësitë e caktuara që hasin autoritetet e prokurimit publik në zbatimin e Ligjit, në këtë rast është parë nevoja që të hartohet Koncept Dokumenti që trajton fushën e Prokurimit Publik.

Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimi Publik në Kosovë është miratuar në shtator të vitit 2011, por gjatë zbatimit janë identifikuar një numër mangësish në këtë ligj të cilat ky koncept dokument ka për qëllim që t'i adresojë mangësitë duke paraqitur propozimet në përputhje me acquis dhe t'i përmbush parimet e përgjithshme të transparencës, mos diskriminimit dhe konkurrencës së ndershme që qeverisin legjislacionin evropian të prokurimit publik.

Qëllimi i këtij dokumenti është përafrimi i fushës së prokurimit publik në Kosovë me acquis të BE-së, për shkak të miratimit të direktivës së re nga BE-ja.

Propozimet për ndryshime reflektojnë nevojat e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, të cilat rrjedhin nga një sondazh i disa niveleve të kryera me akterët kryesorë në sektorë, me konkretisht me autoritetet kontraktuese, me operatorët ekonomikë dhe me organet kombëtare të cilat kanë një kompetencë të drejtpërdrejtë në sektorin e prokurimit publik (KRPP, OSHP, IKAP dhe AQP).

Zotimi i Qeverisë është se kjo çështje do të rregullohet në pajtim me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, duke qenë se kjo çështje është njëherit edhe kërkesë që del nga përmbushja e kriterëve të përcaktuara për liberalizim të vizave.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Me fillimin e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik praktika ka treguar mangësi dhe vështirësi në zbatimin e tij, të cilat edhe kanë krijuar probleme të cilat do të tentohet të evitohen në mënyrën më të mirë përmes opsioneve të cilat do të ofrohen në këtë Koncept Dokument.

Gjatë zbatimit problemet të cilat janë identifikuar kanë të bëjnë me: E prokurimi, çështja e Bordeve, kolizionet e brendshme dhe jashtme, afati i ankesave dhe tarifit e tyre favorizimi i kompanive vendore, prokurime centralizuara, fjalori i përbashkët i prokurimit publik, harmonizimi me kodet buxhetore, çështjet e trajnimeve, harmonizimi i legjislacionit kombëtar me Direktivën e re të BE-se mbi prokurimin publik, prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

1. Përshkruani trendët sa kanë të bëjë me përmasat, lokacionin ose kohëzgjatjen e problemit.

Përmasat dhe Kohëzgjatja e Problemit/Zotimit								
			Viti	Viti	Viti	Viti	Viti	
			2012	2013	2014			
KRPP-aktivitet të monitoruara			151	201	282			
OSHP-shqyrtim të ankesave			331	254	537			

Politika aktuale

Qeveria e Republikës së Kosovës shumë më parë ka kuptuar rëndësinë e funksionit të prokurimit publik dhe rolin e tij në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit si dhe kontributin e tij në anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian në të ardhmen. Si përgjigje ndaj kësaj nevoje, Qeveria duke filluar nga mesi i vitit 2000 ka iniciuar një numër reformash të prokurimit në sistemin e prokurimit publik me qëllim që prokurimi publik të bëhet më efikas dhe me transparent dhe në përputhje me kërkesat, udhëzimet themelore të prokurimit dhe praktikat më të mira e BE-së.

Në Kosovë tashme ekziston një strukturë e përpunuar e sistemit të prokurimit publik për punët, shërbime dhe mallra. Sistemi ka rezultuar nga miratimi i udhëzimeve të BE-së për prokurimin publik, siç janë evoluar gjatë dekadës së fundit të cila në përgjithësi kanë nxitur reformat e prokurimit. Qeveria ka lëvizur shpejt me reforma duke themeluar një kuadër ligjor për prokurimin publik.

Edhe në ditët e sotme prokurimi publik është i lidhur më shumë me tregjet dhe bizneset në blerjen e mallrave dhe shërbimeve dhe të ndërtimit të infrastrukturës publike në kushtet më të mira të mundshme. Megjithatë dihet se ka edhe implikime më të gjera sociale, ekonomike dhe politike të cilat mund të trajtohen në mënyrë të përshtatshme.

Gjatë përpilimit të këtij dokumenti një numër i mangësive kryesore dhe çështjeve prioritare që duhet të adresohen janë identifikuar nga aktorët kryesorë. Çështjet e ngritura janë diskutuar, ratifikuar dhe konfirmuar para studimit të mëtejme. Boshllëqet dhe çështjet janë diskutuar dhe ratifikuar në seminare të veçanta të organizuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Objektivi kryesor në fushën e Prokurimit Publik është:

- Përmirësimi i sistemit të prokurimit publik përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe implementimit të ndryshimeve të nevojshme rregullative;
- Rritja e transparencës dhe efikasitetit dhe, për përmirësimi i fluksit të informatave;
- Përcjellja e trendëve aktuale (prokurimit të gjelbër, prokurimit me përgjegjësi sociale, e-prokurimit, mbështetja e NVM);
- Zhvillimi i mëtejme dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtareve të angazhuar në sistemin e prokurimit publik;

- Qëndrimi në përputhje me direktivat e reja të BE-së.
- Rekomandimet e propozuara mund të grupohen në ndërhyrjet e mëposhtme strategjike:
- Rritja e efikasitetit dhe transparencës së sistemit të Prokurimit Publik;
- Inicimi i proceseve;
- Përmirësimi i qasjes në informata;
- Ngritja e Llogaridhënies;
- Prezantimi i prokurimit publik të gjelbër dhe me përgjegjësi sociale;
- Mbështetje në NVM në prokurimin publik;
- Zhvillimi i Prokurimit Elektronik;
- Zhvillimi i Kapaciteteve Profesionale dhe Burimeve Njerëzore;
- Harmonizimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor për prokurimin, sidomos në pikëpamje të Direktivave të reja të BE-së.

1. Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligjet

Ligjet të cilat ndërlidhen me këtë çështje janë:

Ligji Nr.04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës;

Ligji Nr.04/L -237 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës;

Ligji Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;

Ligji Nr.04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr. 04/L-116

Ligji Nr. 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221;

Ligji Nr.03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;

Ligji Nr. 04/L-045 për partneritet publiko privat.

2. Aktet nënligjore që ndërlidhen me këtë problem/çështje

Rregullore për prokurim publik,

Udhëzues operativ për prokurimin publik,

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2012, dorëzimi i planifikimeve për prokurim dhe informatave plotësuese.

Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012, baza ligjore për zbatimin e procedurave të prokurimit sipas nenit 32 paragrafit 4, nenit 35 dhe nenit 61.

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2014, për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontrata për punë.

Udhëzimi Administrativ Nr.02/2014, për sigurinë e Tenderit, sigurinë e ekzekutimit dhe aplikimin e kriterit përzgjedhës ekonomik dhe financiar.

Udhëzimi Administrativ Nr.03/2014, për disponueshmërinë e mjeteve për udhëheqje të aktivitetit të prokurimit.

Dokumentet standarde për Prokurim publik të miratuara: Planifikimi i prokurimit, Njoftimi paraprak, Njoftimi paraprak për operatorët e SHP, Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, Njoftimi për kontrata, Njoftimi për konkursin e projektimit, Ftesë për ofertim –sipas kontratës publike kornize – mini tender, Njoftimi për dhënie të kontratës, Njoftimi për rezultatet e konkursit të projektimit, Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, Njoftimi për anulimin e dhënies së kontratës, Procesverbali i hapjes së tenderëve, Regjistri i operatoreve ekonomik që e kanë pranuar dosjen e tenderit, Regjistri i tenderëve të dorëzuar, Dosja e Tenderit-Furnizim-Procedure e hapur, Dosja e Tenderit-Shërbime-Procedure e hapur, Dosja e Tenderit-Pune-Procedure e hapur, Dosja e tenderit-Procedure për kuotimin e çmimeve, Dosja e tenderit-Procedure për kuotim me vlere minimale, Dosja e tenderit-Furnizim-Procedure e kufizuar, Dosja e tenderit-Shërbime-Procedure e kufizuar, Dosja e tenderit-Pune-Procedure e kufizuar, Dosja e tenderit-Procedure e negociuar pas publikimit të njoftimit për kontrate, Dosja e konkursit të projektimit-Procedure e hapur, Dosja e konkursit të projektimit-Procedure e kufizuar, Dosja e tenderi-Shërbime Konsulente-Procedure e kufizuar, Dosja e tenderit për kontrate kornize-Furnizim-Procedure e hapur, Dosja e tenderit për kontrate kornize-Shërbime-Procedure e hapur, Dosja e tenderit për kontrate kornize-Furnizim-Procedure e kufizuar, Dosja e tenderit për kontrate kornize-Shërbime-Procedure e kufizuar, Dosja e tenderit për kontrate kornize-Pune-Procedure e kufizuar, Dokumenti Standard i parakualifikimit, Dokumenti standard i parakualifikimit Operator SHP, Njoftimi për sistem të kualifikimit-Operatorët e Shërbimeve Publike, Raporti i vlerësimit të tenderëve-Procedure e hapur, Raporti i vlerësimit të aplikacioneve lista e ngushte-Procedure e kufizuar dhe negociuar, Raporti i vlerësimit të tenderit-Procedure e kufizuar dhe negociuar, Raporti i vlerësimit të tenderëve-Procedure e kuotimit të çmimeve, Dokumenti Standard i Para kualifikimit për konkursin e projektimit, Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, Letër standard për tenderuesin e eliminuar, Letër standard për kandidatet e pa kualifikuar, Letër standard për kandidatet e kualifikuar, Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm, Letër standard për tenderuesit e pasuksesshëm, Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, Letër standarde e ftesës për negociata, Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit-Llogaritje e gabuar, Njoftimi për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontrate-neni 35, Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët-neni 61, Njoftim për përjashtim të kërkesës-me pak se dy tender të përgjegjshëm-neni 32, Raporti vjetor për kontratat e nënshkuara publike, Plani për menaxhimin e kontratave,

Kodi etik i prokurimit, Deklarata nen betim për zyrtaret e prokurimit, Deklarata nen betim për anëtarët e komisionit vlerësues, Deklarata nen betim për punonjësit e KRPP - AQP - OSHP, Rregullat mbi shitjen e asketëve, Dosja e tenderit për shitje, Ftesë për ofertim për shitje, Kërkesë për aprovimin e metodës së shitjes, Kërkesa për shitje, Njoftim për ankand publik për shitje, Njoftim për dhënie të kontratës për shitje, Shitja e asketëve për zyrtaret publik ftesë për ofertim për shitje, Formulari standard për parashtrimin e ankesës në OSHP, Udhëzimet e prokurimit për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës, Kërkesa për kuotim për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës CLICKABLE dhe kërkesa për kuotim për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës MANUAL, Udhë blerja për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës CLICKABLE Udhë blerja për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës MANUAL, Regjistri i ofertave të dorëzuara për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës, Procesverbali i hapjes së kuotimeve për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës, Raporti i vlerësimit për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës CLICKABLE, , Raporti i vlerësimit për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës MANUAL, Llogaria për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës, Pagesat bankare për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës, Pagesa në të gatshme për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës, Shpenzimet për misionet diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës.

LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e

tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

LIGJI NR. 04/L -237 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Gjatë aplikimit të kriterit të ofertës më të favorshme ekonomike dhe në situatat me oferta të dorëzuara nga ofertuesit vendor dhe të huaj, të cilët ofrojnë shërbime, kontratë furnizimi ose kryejnë punë, autoriteti kontraktues përzgjedhë ofertën e ofruesit më të favorshëm vendor, me kusht që dallimi në shumën finale të pikave të mbledhura ndërmjet ofertës më të favorshme të ofertuesit të huaj dhe ofertës më të favorshme të ofertuesit vendor nuk është më e lartë se dhjetë (10) pikë në krahasim me ofertën e ofertuesit të huaj.

Gjatë aplikimit të kriterit të çmimit më të ulët të ofruar, dhe në situatat me oferta të ofertuesve vendor dhe të huaj për ofrim të shërbimeve, kontratë furnizimi ose kryerje të punëve, autoriteti kontraktues përzgjedhë ofertën e ofertuesit vendor me kusht që çmimi i këtij ofertuesi të mos jetë më i lartë se pesëmbëdhjetë për qind (15%) në krahasim me çmimin më të ulët të ofruar nga ofertuesi i huaj.

Në çmimet e ofertuesve, kalkuloohen të gjitha taksat, tatimet dhe tarifatat doganore e aplikueshme në Kosovë. Ofertuesi vendor është person juridik rezident në lidhje me kushtet e ligjit që rregullojnë tatimet në të hyra të personave juridik ose person fizik rezident në lidhje me kushtet e ligjit që rregullojnë tatimin në të hyra të qytetarëve.

Në rast të ofertës së përbashkët, grupi i ofertuesve konsiderohet si ofertues vendor nëse secili anëtar i grupit është person i referuar në paragrafin 4 të këtij neni.

Programi aktual

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak (2015)	Buxheti këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
	000		
	000		

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të prokurimi publik.

Eliminimi i zbrastësirave ligjore, synohet të ndryshohet përmes qasjes për realizimin e zbatimit të prokurimit publik.

Në kuadër të Ministrisë së Financave parashikohet që ky objektivi të mund të arrihet brenda vitit 2015. Mirëpo, për shkak që ky objektivi ndërlidhet edhe me kërkesat për liberalizimin e vizave ekziston një përkushtim që kjo çështje të kryhet sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni *status quo* (asnjë ndryshim)

Dispozitat aktuale në fuqi nuk e rregullojnë në detaje E prokurimin, çështjen e Bordeve, kolizionet e brendshme dhe të jashtme, afati i ankesave, favorizimi i kompanive vendore, prokurime centralizuese, fjalori i përbashkët i prokurimit publik, harmonizimi me kodet buxhetore, çështjet e trajnimeve, harmonizimi i legjislacionit kombëtar me Direktivën e re të BE-se mbi prokurimin publik, prokurimet publike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Mos ndryshim i politikave aktuale do të rezultojnë në mosfunksionimin e pikave të lartcekura. Rrjedhimisht, edhe dispozitat në fuqi që adresojnë këtë çështje nuk do të mund të gjejnë zbatim praktik. Njëkohësisht, Kosova do të dështonte në përpjekjet e saj për harmonizimin e praktikave me shtetet e rajonit dhe shtete anëtare të BE-së e që do të ndikonte në vlerësimin negativ në procesin e integritimit evropian.

Opsioni 2: *Ndryshimi i politikës ekzistuese*

Plotësim ndryshimi i Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës më qëllim hartimit të dispozitave në harmoni me *acquis* për rregullimin e metoda për përcaktimin se kur një tender mund të konsiderohet si jo-normalisht i ulët, tarifat për dorëzimin e ankesave të ë ri-proporcionohet, harmonizimi i legjislacionit kombëtar me Direktivën e re të BE-se mbi PP, funksionimi i OSHP-se, funksionimi i KRPP-se, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, rregullat e preferencës së origjinës, funksionimi i AQP-se, procedurat e tenderimit me më pak se dy oferta të përgjegjshme, gabimet aritmetike, qasja në dokumentacion, prokurimin publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Ky opsion është paraqitur edhe në Planin e Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave dhe Raportin të Progresit për vitin 2014 prandaj opsioni që duhet ndjekur është ndryshimi i politikës ekzistuese.

Opsioni 3: *Ndryshimi i qasjes ekzistues të zbatimit*

Rregullimi i çështjes së prokurimit publik është shumë vështirë të bëhet përmes nxjerrjes së akteve nënligjore në institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjeve ekzistuese që i referohen prokurimit publik. Qëllimi i akteve nënligjore është zbatimi i Ligjit dhe nuk mund të kaloj kompetencat të cilat i delegohen nga Ligji prandaj ky opsion është vështirë të realizohet.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përgatitsni një tabelë që i përmbledh opsionet duke përdorur formën më poshtë. Kjo përmbledhje do t'iu ndihmojë të identifikoni informatat që mund të mungojnë, ose informatat të cilat do ta bëjnë secilin opsion shumë të qartë për vendimmarrësit.

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Nuk ka ndryshim	Krijimi i një drafti të ri për plotësim ndryshim të Ligjit në fuqi	Nxjerrja e akteve nënligjore me qëllim të zbatimit të ligjit.
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar			
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	KRPP	KRPP OSHP AQP	KRPP
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit			
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet			
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat			
Fushatat e edukimit dhe komunikimit		IKAP	
Udhëzimet dhe kodet		Rihartimi i ligjit në fuqi	
Afatet kohore - kur hyn		Sa më parë.	

në fuqi opsioni			
-----------------	--	--	--

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Megjithëse nuk është e mundur që të vlerësohen me siguri përfitimet, pasojat negative dhe kostoja e opsioneve, përmes analizës së informatave në dispozicion dhe konsultimit me grupet e prekura, është e mundur që të krijohet pasqyra më e mirë e saktë.

Përfitimet

Me opsionin e mos ndryshimit të politikës aktuale do të mbetet edhe më tutje një gjendje e rëndë në zbatimin e drejtë të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe do të jetë e vështirë të bëhet funksionalizmi i E Prokurimit dhe rregullimit të dispozitave përkatëse që rregullojnë të drejtën e ankesës, e drejtë kjo që garantohet edhe me Acquis të BE-së. Njëkohësisht, Kosova do të dështonte në përpjekjet e saj për harmonizimin e praktikave me shtetet e rajonit dhe shtete anëtare të BE-së e që do të ndikonte në vlerësimin negativ në procesin e integritimit evropian dhe të anëtarësimit në Këshillin e Evropës. Rregullimi i kësaj çështjeje është paraparë edhe në kuadër të kriterëve të planit për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian.

1. Përfitimet e opsionit 2.

Përmes opsionit të dytë do të arrihet rregullimi i kësaj çështjeje duke hartuar një politikë të re, respektivisht një ligji të ri, përmes të cilit do të përcaktoheshin qartë procedurat e funksionalizmit të sistemit të prokurimit publik të Kosovës. Qëllimi i këtij opsioni do të ishte krijimi i bazës së mirë ligjore që i referohet tenderëve, E prokurimit, çështjes së Bordeve, kolizionet e brendshme dhe të jashtme, afati i ankesave, favorizimi i kompanive vendore, prokurime centralizuese, fjalori i përbashkët i prokurimit publik, harmonizimi me kodet buxhetore, çështjet e trajnimeve, harmonizimi i legjislacionit kombëtar me Direktivën e re të BE-se mbi prokurimin publik. Me aplikimin e prokurimit elektronik në masë të madhe në sistemin e prokurimit publik do të rritet transparenca, efikasiteti, ekonomiciteti, trajtimi i barabartë, si dhe realizimi i parimit kryesor në prokurimit publik "vlera për para". Gjithashtu me aplikimin e prokurimit elektronik do të kursehen mjete të mëdha materiale në shfrytëzimin pajisjeve të zyrës (printerët, aparatet fotokopjuese, skanerëve, etj), materialeve shpenzuese të zyrës (letra, regjistrorët, toneret, hapësirat për arkivim e dokumentacionit, etj), si dhe kursimi i mija orëve të punës të zyrtarëve të Autoriteteve Kontraktuese, ashtu edhe nëpunëseve të Operatorëve Ekonomik.

2. Përfitimet e opsionit 3.

Opsioni i tretë i referohet rregullimit të çështjes së Prokurimit duke nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e ligjeve ekzistuese që i referohen fushës së Prokurimit. Sikurse u paraqit më lartë, ky opsion është vështirë të realizohet pasi që qëllimi i akteve nënligjore është zbatimi i Ligjit dhe nuk mund të kaloj kompetencat të cilat i delegohen nga Ligji prandaj ky opsion është vështirë të realizohet.

Sikur të mund të rregulloheshin çështjet e ngritura në raportin e Progresit dhe procesin e Liberalizimit të vizave si dhe kërkesat nga autoritetet përkatëse të prokurimit publik përmes nxjerrjes së akteve nënligjore, ky opsion do të realizohej më shpejtë duke marrë parasysh që procedurat dhe hapat që duhet të ndjekjen për nxjerrjen e akteve nënligjore janë shumë të thjeshta për dallim nga nxjerrja e Ligjeve.

Pasojat negative

Opsionit 1, (status quo), gjegjësisht mbetja në fuqi e legjislacionit për pa pësuar ndryshime, do të ketë pasoja negative, pasi që do të vazhdonte zbatimi joefikas i legjislacionit që nuk e rregullon këtë çështje dhe nuk i përgjigjet nevojave aktuale për përafrimin e Prokurimit Publik të Kosovës dhe vendet e Bashkimit Evropian. Për më shumë ky opsion nuk është koherent me procesin e Integritimit Evropian, gjegjësisht me legjislacionin në fuqi.

Opsioni 3, Pasojat negative të këtij opsioni janë vështirësia e implementimit të mënyrave të tjera të zbatimit që do të ndikonte në mënyrë direkte në vazhdimin e zbatimit jo efikas të ligjit dhe përafrimi i munguar i legjislacionit nga fusha e Prokurimit Publik me Acquis e BE-së.

Kosto

Përfshini një tabelë e cila përshkruan koston e përafërt të secilit opsion. Një tabelë përmbledhëse është dhënë më poshtë. Të gjitha ministritë duhet të respektojnë udhëzimet përkatëse të nxjerra nga Ministria e Financave, në pajtim me nenin 31 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				

Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				

Kapitulli 7: Konsultimi

Për rregullimin e fushës së lartpërmendur konsultimet janë realizuar konsultime me ekspert të ndryshëm të specializuar në fushën e të ndryshme.

Konsultimet janë bërë me KRPP, ZKM, MF, MTI, AQP, OSHP. Qëndrimi i këtyre institucioneve ishte i përbashkët sa i përket ndryshimit të qasjes aktuale për rregullimin e çështjes së prokurimit publik. Përfaqësues të institucioneve të lartpërmendura kanë marrë pjesë në hartimin e këtij koncept dokumenti duke kontribuar në vlerësimin e problematikës dhe në formulimin e opsioneve për këtë fushë.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1, *status quo* (asnjë ndryshim) sipas vlerësimit do të vazhdonte të mundësonte vazhdimin e pasojave negative, meqenëse do të vazhdohej me zbatimin jo efikas të legjislacionit aktual në fuqi.

Opsioni 2, miratimi i plotësim ndryshimi i Ligjit në fuqi do të mundësonte rregullimin adekuat të fushës së lartpërmendur si dhe do të mundësonte përafrimin e legjislacionit në këtë fushë me atë të *Acquis*.

Opsioni 3, apo nxjerrja e udhëzimeve të brendshme nuk do të aplikohet në praktikë, meqenëse ashtu siç është cekur më lartë, legjislacioni aktual bën zgjidhje të pjesërishme të kësaj problematike.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Rekomandimi i Ekipit përgjigjës është që Koncept Dokumenti të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim që sa më parë të evitohen vështirësitë dhe pengesat që janë paraqitur gjatë zbatimit në praktikë të legjislacionin aktual lidhur me rregullimin e çështjes së fushës së prokurimit publik. Opsioni i rekomanduar në këtë koncept dokument është Opsioni 2 për hartimin e e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të për prokurimin publik. Në rast të miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Financave do të filloj hartimin e të cilin do ta dërgoj në Qeveri për procedim të mëtejshëm.

Kapitulli 10: Komunikimi

Ministria e Financave do të jetë e përqendruar në ofrimin e informacioneve lidhur me detajet e procesit të hartimit të Projektligjit, ku do të merren parasysh konsultimet me ekspertët në fushën e caktuar, si dhe konsultimi me shoqërinë civile të cilët punojnë në fushën e prokurimit publik.

Format e komunikimit do të jenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, grupet punuese dhe publikimet në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, komunikimi do të jetë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe konstruktiv.